



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

RREGULLORE
PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE NË AGJENCINË E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 3, datë 25.04.2017

Tabela e përmbajtjes

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME	2
Neni 1 Baza ligjore.....	2
Neni 2 Objekti.....	2
Neni 3 Përkufizime.....	2
Neni 4 Parimet	3
KREU II NJËSIA PËRGJEGJËSE	4
Neni 5 Përbërja e Njesisë Përgjegjëse	4
Neni 6 Kompetencat e Njesisë Përgjegjëse.....	4
Neni 7 Konflikti i interesit	4
KREU III PROCEDURAT E VEPRIMIT	5
Neni 8 Kryerja e veprimeve procedurale	5
Neni 9 Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit.....	5
Neni 10 Forma dhe përmbajtja e kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja	6
Neni 11 Mosfillimi i hetimit administrativ	6
KREU IV HETIMI ADMINISTRATIV	6
Neni 12 Parimet e hetimit administrativ nga ADISA	6
Neni 13 Regjistrimi i sinjalizimit dhe kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja	7
Neni 14 Procedura e hetimit administrativ.....	7
Neni 15 Provat në hetimin administrativ.....	8
Neni 16 Përfundimi i hetimit administrativ.....	8
KREU V RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE	9
Neni 17 Konfidencialiteti.....	9
Neni 18 Mbrojtja e të dhënave personale	9
KREU VI AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT ADMINISTRATIV	9
Neni 19 Afati për vendimmarrjen	9
Neni 20 Dëmshpërblimi në rastin e hakmarrjes	10
Neni 21 Bashkëpunimi.....	10
Neni 22 Raportimi.....	10
Neni 23 Hyrja në fuqi	10



KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

- 1.1 Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit, mbrojtjen e sinjalizuesit nga hakmarrja dhe konfidencialitetit në ADISA, bazohet në ligjin nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodin e Procedurave Administrative dhe VKM nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 2

Objekti

- 2.1 Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja dhe përcaktimin e mekanizmeve të mbrojtjes së konfidencialitetit, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 3

Përkufizime

- 3.1 Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a. “ADISA” është Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, sipas përcaktimeve të ligjit nr.13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.
 - b. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
 - c. “Hakmarrje” është çdo veprim, i drejtëpërdrejtë/ jo i drejtëpërdrejtë ose kërcënim, i ndërmarrë nga institucioni dhe që ka natyrë diskriminuese, përbën masë disiplinore, ose që në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit si pasojë e sinjalizimit, të kryer prej tij.



- d. “*Mbrojtje*” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
- e. “*ILDKPKI*” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
- f. “*Njësia përgjegjëse*” është organi i posaçëm, i krijuar me urdhër të titullarit të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), që përbëhet nga nëpunës të saj, sipas përcaktimeve të VKM Nr.816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësive përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
- g. “*Sinjalizim*” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).
- h. “*Sinjalizues*” është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë në ADISA, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
- i. “*Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni*” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, se mund të përbëjë korrupsion.

Neni 4

Parimet

- 4.1 ADISA për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, bazohet në parimin e:
- a. ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;
 - b. njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
 - c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktikë të dyshuar të korrupsionit;
 - d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
 - e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
 - f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.



KREU II

NJËSIA PËRGJEGJËSE

Neni 5

Përbërja e Njesisë Përgjegjëse

- 5.1 Njësia Përgjegjëse caktohet me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).
- 5.2 Njësia Përgjegjëse përbëhet nga Përgjegjësi dhe një specialist i Sektorit të Auditit.
- 5.3 Anëtarët e Njesisë Përgjegjëse caktohen pa afat dhe detyra e tyre përfundon me mbarimin e marrëdhënieve të punës në atë pozicion.

Neni 6

Kompetencat e Njesisë Përgjegjëse

- 6.1 Pranon të gjitha sinjalizimet dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja e sinjalizuesve, të ardhura pranë Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).
- 6.2 Shqyrton sinjalizimet dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja e sinjalizuesve.
- 6.3 Fillon procedurën e hetimit administrativ.
- 6.4 Gjatë hetimit administrativ, Njësia Përgjegjëse mund të:
 - kërkojë informacione dhe dokumente;
 - urdhërojë inspektime ose analiza;
 - mbledh deklaratat ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes;
 - konsultohet me ekspertë të fushës.

Neni 7

Konflikti i interesit

- 7.1 Anëtari i Njesisë Përgjegjëse që konstaton se është në kushtet e konfliktit të interesave, sipas përcaktimeve të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe/ose akteve të tjera ligjore, njofton Drejtorin Ekzekutiv.
- 7.2 Drejtori Ekzekutiv zëvendëson anëtarin e Njesisë Përgjegjëse të ndodhur në konflikt interesi, sipas përcaktimeve të VKM Nr.816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njesisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
- 7.3 Në rast se konflikti i interesit konstatohet nga persona të tjerë që kanë lidhje me praktikën



korruptive, e cila është duke u hetuar nga njësi përgjegjëse, ato njoftojnë Drejtorin Ekzekutiv, i cili pasi vërteton pretendimin e tyre, vepron për zëvendësimin e tij, sipas përcaktimeve të 7.2.

KREU III

PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 8

Kryerja e veprimeve procedurale

- 8.1 Veprimet procedurale të ADISA kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
- 8.2 Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat ADISA cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 9

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

- 9.1 Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para Njesisë Përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej saj.
- 9.2 Sinjalizimi përmban të paktën:
 - të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
 - të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
 - përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
 - në rastin e sinjalizimit tek ADISA, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.
- 9.3 Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga ADISA si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
- 9.4 Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme, sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.



Neni 10

Forma dhe përmbajtja e kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja

- 10.1 Kërkesa bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar osë deklarohet verbalisht para Njesisë Përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej saj.
- 10.2 Kërkesa për mbrojtjen nga hakmarrja duhet të përmbajë fakte, rrethana ose arsye që sinjalizuesi i konsideron si një akt hakmarrjeje.

Neni 11

Mosfillimi i hetimit administrativ

- 11.1 ADISA ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:
 - a. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
 - b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;
 - c. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.
 - d. kërkesa për mbrojtje nga hakmarrja nuk është bërë sipas përcaktimeve të Nenit 9 të kësaj rregulloreje.
- 11.2 Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit Ekzekutiv të ADISA-s.

KREU IV

HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 12

Parimet e hetimit administrativ nga ADISA

- 12.1 Në kryerjen e hetimit administrativ ADISA vepron:
 - a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit;
 - b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
 - c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;

- d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
- e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
- f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 13

Regjistrimi i sinjalizimit dhe kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja

- 13.1 Sinjalizimet dhe/ose kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.
- 13.2 ADISA nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit dhe/ose kërkesës për mbrojtjen nga hakmarrja.

Neni 14

Procedura e hetimit administrativ

- 14.1 Njësia Përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin dhe/ose kërkesën për mbrojtje nga hakmarrja, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, Njësia Përgjegjëse zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
- 14.2 Njësia Përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
- ~~14.3 Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga Njësia Përgjegjëse.~~
- 14.4 Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
- mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
 - ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
- 14.5 ADISA njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, ADISA është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
- 14.6 ADISA merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për atë që është e mundur, për të



parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

- 14.7 Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga ADISA, rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, Drejtori Ekzekutiv, sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

Neni 15

Provat në hetimin administrativ

- 15.1 ADISA dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të nëpunësve të ADISA për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
- 15.2 Njësia Përgjegjëse ka të drejtë të këqyrë sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit ose hakmarrjes. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.
- 15.3 Në raste të veçanta, Njësia Përgjegjëse vlerëson se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, bllokun dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës të ADISA apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga anëtarët e njësisë përgjegjëse dhe zyrtarët përgjegjës të ADISA apo personat e tjerë. Zhblllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv të ADISA.
- 15.4 Gjatë ushtrimit të detyrës Njësia Përgjegjëse zbaton, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 16

Përfundimi i hetimit administrativ

- 16.1 Njësia Përgjegjëse përfundon hetimin administrativ nëse:
- a. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, Drejtori Ekzekutiv njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.
 - b. sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 60/2016.
- 16.2 Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga Drejtori Ekzekutiv, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen



përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin dhe/ose kërkesën për mbrojtje nga hakmarrja.

KREU V

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 17

Konfidencialiteti

- 17.1 Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit dhe/ose kërkesës për mbrojtje identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
- 17.2 ADISA duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin dhe/ose kërkesën për mbrojtje nga hakmarrja, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

Neni 18

Mbrojtja e të dhënave personale

- 18.1 Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 18.2 Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VI

AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT ADMINISTRATIV

Neni 19

Afati për vendimmarrjen

- 19.1 Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga ADISA përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
- 19.2 Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit Ekzekutiv



duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

Neni 20

Dëmshpërblimi në rastin e hakmarrjes

- 20.1 Nëse në përfundim të hetimit administrative të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtje nga hakmarrja, rezulton se është kryer një akt hakmarrje ndaj tij, ADISA merr të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Ndaj personit i cili ka kryer veprime hakmarrëse ndaj sinjalizuesit, Drejtori Ekzekutiv merr masa në bazë të legjislacionit në fuqi.
- 20.2 Sinjalizuesi ka të drejtë të kërkojë në gjykatë shpërblim për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes, në kuptim të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, sipas Kodit Civil.

Neni 21

Bashkëpunimi

- 21.1 ADISA bashkëpunon me ILDKPKI dhe çdo subject tjetër publik ose privat në zbatim të kësaj rregullore.

Neni 22

Raportimi

- 22.1 Njësia përgjegjëse zbaton detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja për lehtësimin dhe zhvillimin e procesit të sinjalizimit, ~~si dhe i paraqet ILDKPKI-së çdo vit, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, nëse ka të tilla, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.~~

Neni 23

Hyrja në fuqi

- 23.1 Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Këshilli Drejtues i ADISA.
- 23.2 Çdo ndryshim, shtesë apo shfuqizim i dispozitave të kësaj rregulloreje bëhet me miratim nga Këshilli Drejtues i ADISA.

